**BASHKIA MIRDITE**

*Nr._____Prot* *Rreshen, me ____/____/2020*

**Shtojca 16**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor*]

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: ***"CURRI'SHPK, TIRANE***

Adresa: Tirane, Njesia Administrative Nr.10, Rruga Kajo Karafili, Nd.2, H.4, Ap.3, 1001

Procedura e prokurimit: PH-PUNE

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-54908-03-25-2020.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "***Ndertim i ujesjellesit për qytetin Rubik***", *BASHKIA MIRDITE. Afati 12 (dymbedhjete) muaj.*

Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.**"GECI" SHPK, TIRANE** **K71829801O**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera: 107'813'999 Lek (njeqind e shtate milion e teteqind e trembedhjete mije e nenteqind e nentedhjete e nente) lek

*(me numra dhe fjalë)*

2. **"AEK MUNELLA" & "JUNIK" SHPK** **J98926001P & J68007522L**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera: 108'174'003 Lek (njeqind e tete milion e njeqind e shtatedhjete e kater mije tre) lek

*(me numra dhe fjalë)*

3.**"KUPA" & "2T" SHPK, TIRANE** **K51615512C & K01731001M**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera: **116'748'583** Lek (njeqind e gjashtembedhjete milion e shtateqind e dyzet e tete mije e peseqind e tetedhjete tre) lek

*(me numra dhe fjalë)*

4.**"4 A-M" SHPK, TIRANE** **K9200501L**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera: **118'041'361** Lek (njeqind e tetembedhjete milion e dyzet e nje mije e treqind e gjashtedhjete e nje) lek

*(me numra dhe fjalë)*

5.**"CURRI" SHPK, TIRANE** **J67902718S**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera: **120'427'521** Lek (njeqind e njezet milion e katerqind e njezet e shtate mije e peseqind e njezet e nje) lek

*(me numra dhe fjalë)*

6. **"PE-VLA-KU" SHPK, TIRANE** **K61716013M**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera: **121'561'977** Lek (njeqind e njezet e nje milion e peseqind e gjashtedhjete e nje mije e nenteqind e shtatedhjete e shtate) lek

*(me numra dhe fjalë)*

7. **"A.N.K." shpk, TIRANE** **J92408001N**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera: **122'105'696** Lek (njeqind e njezet e dy milion e njeqind e pese mije e gjashteqind e nentedhjete e gjashte) lek

*(me numra dhe fjalë)*

* * *

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1.**"GECI" SHPK, TIRANE** **K71829801O**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. **"AEK MUNELLA" & "JUNIK" SHPK** **J98926001P & J68007522L**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

3.**"KUPA" & "2T" SHPK, TIRANE** **K51615512C & K01731001M**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

4.**"4 A-M" SHPK, TIRANE** **K9200501L**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

5. **"PE-VLA-KU" SHPK, TIRANE** **K61716013M**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

6. **"A.N.K." shpk, TIRANE** **J92408001N**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

* * *

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1.**"GECI" SHPK, TIRANE**

1. Nuk ka permbushur piken 2.3.3,b, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për kapacitetet teknike: -të paktën 50 punonjës të certifikuar me dëshmi te sigurimit teknik lëshuar nga ISHTI ose ekuivalente.
2. Nuk ka permbushur piken 2.3.5 Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve ne pronësi/qira pasi dhe referuar deklaratës se paraqitur nga ana e tij rezulton qe nuk ka dorëzuar dokumentacion qe vërteton qe disponon kapacitetet teknike Fabrike prodhim betoni dhe Fabrike prodhim inertesh Në pronësi / me qira / kontrate furnizimi, si dhe dokumentacionin shoqërues te tyre.
3. Nuk ka permbushur piken 2.3.6, pasi nuk ka paraqitur ISO IEC 27001.
4. Nuk ka përmbushur piken 2.3.10. Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor / nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent.
5. Nuk ka përmbushur piken 2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e punimeve te ngjashme, pasi ne kontraten e paraqitur per objektin "Furnizimi me uje i plazheve Durres-Kavaje nga pus-shpimet e Çermes....." mungon certifikata e marrjes ne dorezim.

2. **"AEK MUNELLA" & "JUNIK" SHPK**

1. Kontrata e bashkëpunimit mes dy shoqërive eshte lidhur mbi bazën e **VKM-se Nr. 1, date 10.12.2007, "Për rregullat e prokurimit publik", vendim i cili eshte e shfuqizuar me VKM-ne Nr. 914 datë 29.12.2014.** Referuar kësaj, punimet jane ndare ne masën 40% nga "AEK Munella" shpk dhe 60% nga "JUNIK" shpk si dhe ne zerat e punimeve mbi bazen e kapitujve te punimeve. Referuar preventivit te paraqitur rezulton qe "AEK Munella" shpk ka marre persiper te kryej 38.33% te punimeve ndersa "JUNIK" shpk 61.67%.
2. Operatori "JUNIK" shpk, pjese e këtij bashkimi, nuk ka përmbushur piken 2.3.1 Përvojë në realizimin e puneve te ngjashme.
   Kontrata e ngjashme e paraqitur nga operatori "JUNIK" shpk, me objekt "Rehabilitimi i rrjetit ujësjellës ne Lezhe" nënshkruar me subjektin "Trema Engineering 2" shpk, është jashtë afatit te përcaktuar ne kriteret për kualifikim, ku thuhet "*...të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tri viteve të fundit nga* ***data e zhvillimit të procedurës së prokurimit***". Bazuar ne aktin e kolaudimit te paraqitur ne tender, "Taking Over" si dhe formularit te vlerësimit, punimet kane përfunduar dhe **janë kolauduar ne datën 4 prill 2017.**

Në nenin 74 pika 3 të Vendimit Nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar parashikohet se: " 3. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga **anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim**. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim." Në rastin konkret operatori ekonomik "JUNIK" shpk, në cilësinë e operatorit ekonomik që ka përqindjen më të madhe (60%) duhet të dëshmonte eksperiencë të ngjashme në një kontratë të vetme sa 50 % e vlerës së fondit limit qe prokurohet, gje te cilën nuk e disponon.

3. Operatori "AEK Munella" shpk, pjese e këtij bashkimi nuk ka përmbushur piken 2.3.2, ne raport me përqindjen e marre përsipër sipas kontratës se bashkëpunimit. Ne rastin konkret ky operator duhet të ketë një punësim mesatar i të paktën 48 punonjës me kohë të plotë pune, për periudhën Janar 2019 – dhjetor 2019, ndërsa rezulton qe ka 39 punonjës, ne kundërshtim me këtë kriter dhe rregullat e prokurimit publik, neni 74. "*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare,* ***profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë****, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje*".
4. Operatori "AEK Munella" shpk, pjese e këtij bashkimi nuk ka përmbushur piken 2.3.3,b, ne raport me përqindjen e marre përsipër sipas kontratës se bashkëpunimit për kapacitetet "Manovratorë të mjeteve të rënda, vërtetuar me kontratë pune e cila duhet të jetë e vlefshme, dhe me Dëshmi Aftësimi Profesional të vlefshme". Punonjësit e paraqitur si manovratore nuk disponojnë **Dëshmi Aftësimi Profesional** të vlefshme.
5. Operatori "AEK Munella" shpk, pjese e këtij bashkimi nuk ka përmbushur piken 2.3.6, pasi nuk ka paraqitur **ISO IEC 27001** dhe **ISO 50001.**
6. Operatori ekonomik "AEK Munella" shpk, sipas licences profesionale te shoqerise me Nr. NZ.2802/20, date 12.11.2019 dhe nga te dhenat e formularit E - SIG 025 "*Listpagesat e kontributeve te sigurimeve shoqerore, shendetesore dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi*", te paraqitur nga subjekti, **rezulton qe per muajin dhjetor 2019 per dy drejtues teknik, nuk jane derdhur sigurimet shoqerore,** kjo ne kundershtim me "Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit", pika 2.3.2, te DST-se.

3.**"KUPA" & "2T" SHPK, TIRANE**

1. Kontrata e bashkëpunimit mes dy shoqërive eshte lidhur mbi bazën e **VKM-se Nr. 1, date 10.12.2007, "Për rregullat e prokurimit publik", vendim i cili eshte e shfuqizuar me VKM-ne Nr. 914 datë 29.12.2014.**. Referuar kësaj, punimet jane ndare ne masën 20% nga "2T" shpk dhe 80% nga "KUPA" shpk si dhe ne zerat e punimeve. BOE ka paraqitur dokument me pasaktesi dhe mosperputhje te % se ndarjes se punimeve sipas akt marreveshjes se bashkepunimit me % qe rezulton sipas ndarjes konkrete te punimeve per secilin prej operatoreve pjesemarres. Referuar preventivit te paraqitur rezulton qe "2T" shpk ka marre persiper te kryej 25% te punimeve, ndersa "KUPA" shpk 75%. Kjo bie ne kundershtim me nenin 74, pika 1 dhe 2 të, VKM-se, 914/2014.
2. Ne vërtetimin e paraqitur që konfirmon shlyerjen e pagesave te energjise elektrike, rezulton qe subjekti "KUPA" shpk, pjese e këtij bashkimi, ne kundërshtim me piken 1/dh te kritereve te veçanta per kualifikim nuk ka shlyer detyrimet të maturuara të energjisë **elektrike te muajit mars 2020**. (Mbi detyrimet e maturuara sipas Vendimit te ERE-s, Nr.109, date 21.10.2011, "Per miratimin e kontratës se furnizimit me energji elektrike te klientëve jofamiljare, neni 9/1, Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.")
3. Nga te dhenat e licences profesionale te shoqerise "KUPA" shpk, me Nr. NZ.4901/11, date 03.12.2019, dhe formularit E - SIG 025 "*Listpagesat e kontributeve te sigurimeve shoqerore, shendetesore dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi*", te paraqitur nga subjekti, **rezulton qe per muajin dhjetor 2019 (referuar dates se marrjes se licences) per drejtuesen teknike, znj. Erjola Duka, nuk jane derdhur sigurimet shoqerore.**Kjo bie ne kundershtim me kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-ne Nr.42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 9/c ku percaktohet se *Shoqëritë e licencura jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose* ***ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës*** *(aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë*. Dhe ne vijim Kreu VII, ku percaktohet se *Shoqërise qe kryen veprimtari pa drejtues teknik ose shkel afatet e njoftimit të caktuara në këtë rregullore, komisioni i heq licencën për shoqërinë/drejtuesit për një periudhë 3 vjet.*
4. Nuk ka përmbushur piken 2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e punimeve te ngjashme, pasi ne kontraten e paraqitur per objektin "Ndertim i sistemit te ujrave te zeza Vlore" nga "2T" shpk mungon certifikata e marrjes ne dorezim. Po keshtu ne kontraten e paraqitur nga "KUPA" shpk per objektin "Rikonstruksion i ujesjellesit sektori Qender, Njesia Administrative Sukth, Bashkia Durres" mungon certifikata e

marrjes ne dorezim.

4.**"4 A-M" SHPK, TIRANE**

1. Operatori **"4 A-M"** shpk, nuk ka përmbushur piken 2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e punimeve te ngjashme, pasi ne kontraten e paraqitur per objektin "Rikonstruksion rrjet ujesjellesi ne zonen Babrru Qender" eshte jashte afatit te percaktuar ne kerkesat e DST. Akti i kolaudimit te ketij objekti mban daten **08.03.2017**. Ne kontraten e dyte te paraqitur per objektin e dyte "Linje transmetimi nga baseni i presionit ne dalje te tunelit Dajt-takimin me tubacionin e depos gurore (puseta e marrjes Fush Dushk)" mungon certifikata e marrjes ne dorezim.
2. OE ka refuzuar te pranoje oferten e korigjuar nga KVO si dhe ka njoftuar terheqjen nga gara.

5. **"PE-VLA-KU" SHPK, TIRANE**

1. Nuk ka permbushur piken 2.3.3,b, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për kapacitetet: - të paktën 50 punonjës të certifikuar me dëshmi te sigurimit teknik lëshuar nga ISHTI ose ekuivalente.
2. Nuk ka permbushur piken 2.3.5 Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion dhe kontratat e furnizimit ne kundershtim me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit.
3. Nuk ka përmbushur piken 2.3.6, pasi ISO I OHSAS 18001 ka skaduar ne date **19.04.2020**, ne kundërshtim me kriterin e dhënë ne dokumentet e tenderit.

6. **"A.N.K." shpk, TIRANE**

1. Nuk ka permbushur piken 2.3.3,b, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për kapacitetet teknike specialiste, ne kundërshtim me kriterin e dhënë ne dokumentet e tenderit.

2. Nuk ka permbushur piken 2.3.5 Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, ne kundërshtim me kriterin e dhënë ne dokumentet e tenderit.

---

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **"CURRI" shpk, Tirane**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej ***120'427'521 Lek (njeqind e njezet milion e katerqind e***

***njezet e shtate mije e peseqind e njezet e nje) lek*** /pikët totale të marra *[_____]*është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë ***Bashkise Mirdite, Sheshi 'Abat Doci,"Rreshen Mirdite (Sektori i prokurimeve)***, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda ***30 (tridhjete)*** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej ........ (perseritet procedura), siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 01.06.2020

Ankesa: ka ose jo____ka patur_____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë 10.06.2020

**KRYETARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Ndrec DEDAJ**